



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.156

27 nëntor

2011

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|--|---|------|
| Ligj nr.10 473 datë 27.10.2011 | Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për konvertimin e borxhit për zhvillim”..... | 7489 |
| Ligj nr.10 477 datë 3.11.2011 | Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë për shlyerjen e shumave në llogarinë e shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë”..... | 7494 |
| Vendim i KM nr.744, datë 26.10.2011 | Për dhënie ndihme financiare Qeverisë së Republikës Demokratike të Somalisë, për lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga thatësira e tejjgatur..... | 7497 |
| Vendim i KM nr.745, datë 20.10.2011 | Për strukturat e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM)..... | 7497 |
| Vendim i KM nr.746, datë 12.10.2011 | Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, për çështjen nr.13205-FM “Italstrade s.p.a., kundër Republikës së Shqipërisë”..... | 7498 |
| Udhëzim i MASH nr.43, datë 31.10.2011 | Për disa shtesa në udhëzimin nr.38, datë 23.9.2011 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012”..... | 7499 |
| Vendim i GJK nr.49, datë 21.11.2011 | Me objekt: - Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut; - Dëmshpërblimin e dëmit si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor..... | 7500 |

| | | |
|---|--|------|
| Vendim i BSH nr.75, datë 26.10.2011 | Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”..... | 7503 |
| Vendim i ERE nr.107, datë 17.10.2011 | Për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s..... | 7504 |
| | Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Eda Hasani..... | 7509 |

LIGJ
Nr.10 473, datë 27.10.2011

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË PËR
KONVERTIMIN E BORXHIT PËR ZHVILLIM”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për konvertimin e borxhit për zhvillim”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7152, datë 10.11.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
**MBI KONVERTIMIN E BORXHIT PËR ZHVILLIM NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeveria e Republikës së Italisë, këtu të quajtura “palët”, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit të tyre dypalësh dhe uljen e barrës së borxhit shqiptar,

duke marrë parasysh se:

një protokoll dypalësh për bashkëpunimin për zhvillim u nënshkrua nga palët në Tiranë, më 12 prill 2010;

në kuadër të protokollit dypalësh për bashkëpunimin për zhvillim u ra dakord për një “Program konvertimi të borxhit për zhvillim” për një shumë të përgjithshme prej 20 (njëzet) milionë eurosh;

palët ranë dakord që fondet që rrjedhin nga “Programi i konvertimit të borxhit për zhvillim” të përdoren për të financuar projekte zhvillimi për zhvillimin social dhe veçanërisht projekte që përqendrohen në gjenerimin e arsimit, shëndetit dhe punësimit,

palët kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1.1 Kjo marrëveshje përbëhet nga 7 nene dhe 1 aneks, që përbën pjesë integrale të saj.

1.2 Kjo marrëveshje ka të bëjë me operacionet e konvertimit të borxhit për zhvillim, të borxhit dypalësh të Asistencës Zyrtare për Zhvillim (ODA) që ka Republika e Shqipërisë ndaj Republikës së Italisë, dhe vendos procedurat për zbatimin e këtyre operacioneve.



1.3 Kjo marrëveshje zbatohet për këstet e huave të renditura në aneksin 1 (principali dhe interesi) të kërkueshme, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Shuma e borxhit që u nënshtrohet operacioneve të konvertimit sipas kësaj marrëveshjeje nuk i kalon 20 (njëzet) milionë euro.

1.4 Çdo borxh tjetër i tashëm dhe i ardhshëm që ka Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ndaj Qeverisë Italiane mbetet i pandikuar nga kjo marrëveshje.

1.5 Projektet e përshtatshme për operacionet e konvertimit do të financohen pjesërisht ose plotësisht nga Qeveria Italiane nëpërmjet kësaj marrëveshjeje dhe do të lidhen me projekte dhe programe sociale dhe zhvillimi të rëna dakord bashkërisht.

Neni 2

Procedurat e konvertimit të borxhit për zhvillim

2.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, shuma e mbetur e kërkueshme (principali dhe interesi) e huave të renditura në aneksin 1 do të pezullohet deri në një shumë maksimale prej 20 milionë eurosh. Në të njëjtën kohë, Qeveria e Republikës Italiane i komunikon Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, nëpërmjet shkëmbimit të letrave, një plan që përmban një listë të detajuar të kësteve (principalin dhe interesin) referuar shumës së mësipërme të papaguar, që do të anulohen.

2.2 Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ngre një Fond Homolog (CPF) në Bankën Qendrore të Shqipërisë në emrin e “Marrëveshjes së konvertimit të borxhit italo-shqiptar-Komiteti Menaxherial”.

2.3 Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë depoziton në Fondin Homolog (CPF) shumën e parashikuar në nenin 1.3 në njëmbëdhjetë këste. Secili këst konvertohet në lekë sipas kursit të këmbimit euro/lekë të kuotuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në të njëjtën datë të depozitimit të këstit. Kësti i parë që konvertohet nga 500 000 euro depozitohet në CPF brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes. Dhjetë këstet e tjera pasuese gjashtëmujore depozitohen çdo 31 tetor dhe 30 prill pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes. Secili këst, nga i dyti tek i njëmbëdhjeti, është i barabartë me 1.95 milionë euro.

2.4 Ministria e Financave e Shqipërisë, e mbështetur nga njësia e mbështetjes teknike (TSU) e përmendur në nenin 4.5, u komunikon, nëpërmjet Ambasadës Italiane Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme-Drejtorisë së Përgjithshme për Bashkëpunim për Zhvillimin (MFA-DGDC) dhe menaxherit të huave ODA të Institucionit Financiar Italian (IFI), brenda 15 ditëve nga secila depozitë, informacionin e mëposhtëm:

- Shumën në lekë të depozituar në CPF dhe kursin e këmbimit të zbatuar (bashkëlidhur dokumentet administrative përkatëse që tregojnë shumën e depozituar);
- Shumën e mbetur në CPF dhe interesin e mbledhur (sipas rastit).

Brenda 15 ditëve nga marrja e informacionit të mësipërm, Institucioni Financiar Italian i jep Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë një deklaram njohjeje për saktësinë e shumës së depozituar në CPF.

2.5 Në fund të periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes, të përcaktuar në nenin 7.2, e gjithë shuma e kredituar në Fondin Homolog dhe disbursuar në pajtim me nenin 3, konsiderohet e anuluar.

2.6 Brenda 30 ditëve pune nga njoftimi i Institucionit Financiar Italian, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i paguan Qeverisë Italiane të gjithë shumën e kredituar në CPF dhe që nuk është disbursuar në pajtim me nenin 3 (të barabartë me shumën e mbetur në CPF) me të njëjtën normë fillestare këmbimi. Interesi i mbledhur (sipas rastit) dhe/ose interesi i vonuar (sipas rastit, i llogaritur pas 30 ditëve pune nga njoftimi i Institucionit Financiar Italian) është i pagueshëm.

Neni 3

Përdorimi i fondeve CPF dhe projektet e përshtatshme

3.1 Fondet që rrjedhin nga operacionet e konvertimit të borxhit dhe të depozituara në CPF, duke përfshirë interesat e mbledhura nëse ka të tilla, do të përdoret për të financuar projektet e zhvillimit të

rëna dakord bashkërisht, asistencën teknike për zbatimin e duhur të programit, si dhe personelin dhe funksionimin e njësisë së mbështetjes teknike të përmendur në nenin 4.5 të mëposhtëm.

3.2 Projektet e përshtatshme do të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik në Shqipëri dhe do të identifikohen brenda kuadrit të protokollit dypalësh shqiptaro-italian për bashkëpunimin për zhvillim të nënshkruar në Tiranë më 12 prill 2010. Fondet e mbledhura në CPF mund të përdoren, gjithashtu, për të financuar kostot lokale të projekteve dhe programeve përkatëse të financuara nga Bashkëpunimi Italian për Zhvillim në Shqipërisë.

3.3 Prioritet u jepet projekteve që përqendrohen në gjenerimin e arsimit, shëndetësisë dhe punësimit, dhe projekteve përkatëse që përfshihen në kuadrin e programit të asistencës italo-shqiptare, dhe të rëna dakord nga palët, në kontekstin e pjesëmarrjes sociale të verifikueshme dhe përdorimit të burimeve të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore.

3.4 Të gjitha institucionet publike shqiptare kanë të drejtë të paraqesin kërkesa te Komiteti Menaxherial i përmendur në nenin 4 të mëposhtëm. Aplikimet për projekte dhe modalitetet e ekzekutimit tregohen në manualin operacional të programit të përmendur në nenin 4.2.

3.5 Projektet e zbatuara sipas kësaj marrëveshjeje paraqiten si të financuara bashkërisht nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane.

3.6 Faturat dhe dokumentet e tjera në lidhje me projektet do të mbahen në dosje për pesë vjet pas përfundimit të projektit dhe i vihen në dispozicion Qeverisë Italiane me kërkesë të saj. Pala italiane ka të drejtë të vizitojë vendet e projekteve gjatë dhe pas zbatimit të tyre.

Neni 4

Komiteti Menaxherial

4.1 Ngrihet një Komitet Menaxherial për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe ai përbëhet:

- Në emër të Qeverisë Italiane, nga SHT ambasadori i Republikës Italiane në Republikën e Shqipërisë ose përfaqësuesi i tij/saj, i asistuar nga anëtarët e Ambasadës Italiane, Zyrës Italiane të Bashkëpunimit dhe/ose MFA-DGDC, sipas rastit;

- Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nga SHT Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë ose përfaqësuesi i tij/saj, i asistuar nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, Departamenti i Strategjisë dhe Bashkërendimit të Donatorëve pranë Këshillit të Ministrave dhe ministritë e tjera përkatëse dhe/ose organizata, sipas rastit.

4.2 Komiteti Menaxherial ka detyrat e mëposhtme:

- Të monitorojë zbatimin e përgjithshëm të kësaj marrëveshjeje;
- Të monitorojë pjesën e mbetur të CPF-së, shumat e konvertuara dhe të transferuara në CPF, shumat e fondeve të transferuara dhe që duhet të transferohen nga CPF-ja te projektet e financuara;
- Të miratojë Manualin Operacional të Programit (OMP), me qëllim vendosjen e rregullave dhe procedurave për zgjedhjen dhe financimin e projekteve, modalitetet e monitorimit dhe vlerësimit etj.;
- Të përzgjedhë projektet për financim në pajtim me këtë marrëveshje dhe me rregullat, dhe procedurat e vendosura nga OMP-ja;
- Të verifikojë arritjet e projekteve dhe të monitorojë zbatimin e projekteve nëpërmjet vizitave në terren dhe vlerësimit të dokumentacionit, si raportet e progresit dhe përfundimtare, raportet e auditit financiar, siç do të vendoset brenda OMP-së.

4.3 Komiteti Menaxherial u jep palëve raporte progresi gjashtëmujore, duke përfshirë informacionin mbi situatën e CPF-së dhe mbi të gjitha projektet e financuara, duke përshkruar aktivitetet kryesore dhe disbursimet përkatëse të kryera.

4.4 Komiteti Menaxherial mbledhet çdo gjashtë muaj dhe operon sipas rregullave dhe procedurave që do të vendosen bashkërisht nga palët. Mbledhja e parë zhvillohet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje. Pjesa e parë e projekteve paraqitet dhe, nëse është e mundur, miratohet në mbledhjen e parë.

4.5 Ngrihet një njësi mbështetjeje teknike (TSU) për të asistuar Komitetin Menaxherial në përmbushjen e detyrave të tij. Termat e referencës dhe përgjegjësitë e TSU-së përcaktohen brenda OMP-



së. Njësia përbëhet nga një ekspert italian, një ekspert shqiptar, si dhe nga personeli mbështetës. Ekspertët e Njesisë së Mbështetjes Teknike veprojnë, gjithashtu, si Sekretariat i Komitetit Menaxherial dhe raportojnë drejtpërdrejt te Komiteti Menaxherial. Kostoja për personelin, pajisjet dhe funksionimin e TSU-së mbulohet me fondet e CPF-së. Buxheti për asistencë teknike dhe për TSU-në miratohet nga Komiteti Menaxherial sipas planeve gjashtëmujore të veprimit dhe planeve përkatëse financiare të përgatitura nga TSU-ja. Buxheti për TSU-në nuk është në asnjë rast më shumë se 3% e shumës së përgjithshme.

Neni 5 Ndryshimet

5.1 Kjo marrëveshje dhe aneksi i saj mund të ndryshohen nëpërmjet shkëmbimit të letrave.

Neni 6 Mosmarrëveshjet

6.1 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 7 Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

7.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit nga të dyja njoftimet, nëpërmjet të cilëve të dyja palët kontraktuese kanë komunikuar zyrtarisht me njëra-tjetrën që procedurat e tyre përkatëse të brendshme janë përfunduar.

7.2 Kjo marrëveshje mbetet në fuqi deri dy vjet pasi kësti i fundit të jetë depozituar në CPF. Zgjatja e saj mund të bihet dakord bashkërisht, në rast se fondet e caktuara për projekte dhe aktivitete specifike nuk janë shpenzuar deri në datën e mbarimit.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e nënshkruar, duke qenë rregullisht të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje në gjuhën angleze.

Bërë në _____ më _____, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

ANEKSI I

| Kredia | Përshkrimi | Data e nënshkrimit | Monedha | Angazhimi fillestar | Data e maturimit |
|----------|---|--------------------|---------|---------------------|------------------|
| 91/029/0 | Program i financimit për importet e mallrave me origjinë italiane | 7/19/1991 | Euro | 15,493,706.97 | 22/01-22/07 |
| 91/049/0 | Program i financimit për importet e mallrave me origjinë italiane (faza II) | 11/15/1991 | Euro | 15,493,706.97 | 12/06-12/12 |
| 92/016/0 | Financimi i mallrave dhe shërbimeve italiane për ndërtimin e një njësie industriale për prodhimin e produkteve dietike për fëmijë | 10/27/1992 | Euro | 4,585,104.35 | 16/06-16/12 |
| 94/006/0 | Normalizimi dhe zgjerimi i sistemit të ujit – faza I | 2/21/1995 | Euro | 6,713,939.69 | 24/08-24/08 |

| | | | | | |
|----------|--|------------|------|---------------|-------------|
| 94/012/0 | Realizimi i një telekomunikimi të integruar | 2/21/1995 | Euro | 6,854,602.70 | 24/08-24/08 |
| 95/003/0 | Financimi i rehabilitimit të hekurudhës Tiranë-Durrës | 6/14/1995 | Euro | 3,098,741.39 | 17/01-17/07 |
| 95/006/0 | Rehabilitimi i rrjetit elektrik të Tiranës, Shkodrës dhe Durrësit | 2/19/1996 | Euro | 4,441,529.33 | 21/03-21/09 |
| 95/007/0 | Ndërtimi i veprës ujore të Bovillës për furnizimin me ujë të Tiranës- faza II | 3/18/1996 | Euro | 11,362,051.78 | 27/05-27/11 |
| 98/001/0 | Financimi i aktivitetit të "prokurimit" për realizimin e programit | 7/6/1998 | Euro | 11,362,051.78 | 08/01-08/07 |
| 99/004/0 | Rehabilitimi i sistemit të shpërndarjes së ujit në Tiranë | 5/11/2000 | Euro | 27,475,507.03 | 13/03-13/09 |
| 99/010/0 | Punë në infrastrukturën e furnizimit me ujë në Tiranë | 5/11/2000 | Euro | 3,511,906.91 | 13/03-13/09 |
| 00/001/0 | Mbështetje e programit për sektorët e ngrohjes, energjisë elektrike, ujit dhe pastrimit | 5/11/2000 | Euro | 11,362,051.78 | 13/03-13/09 |
| 00/010/0 | Ndërtimi i seksionit të rrugës Tapizë-Fushë-Krujë dhe urat në lumenjtë e Drinit dhe Matit | 2/20/2001 | Euro | 6,565,775.76 | 30/03-30/09 |
| 02/004/0 | Program i mbështetjes financiare për blerjen e energjisë elektrike nga Italia, trajtim i krizës së energjisë elektrike të tashme në Shqipëri | 6/11/2002 | Euro | 8,505,697.00 | 12/06-12/12 |
| 03/006/0 | Programi i ristrukturimit dhe fuqizimit teknik dhe menaxherial të sistemit të energjisë elektrike shqiptare KESH | 7/16/2003 | Euro | 41,528,041.03 | 07/03-07/09 |
| 04/006/0 | Programi për rrethinat e Bashkisë së Tiranës komponentët e infrastrukturës në Laprakë | 11/23/2005 | Euro | 3,000,000.00 | 12/01-12/07 |
| 04/009/0 | Programi për ristrukturimin dhe pajisjen e pesë klinikave në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë | 11/23/2005 | Euro | 5,080,000.00 | 04/02-04/08 |
| 04/010/0 | Programi i menaxhimit të mbetjeve interte në Tiranë | 11/23/2005 | Euro | 6,000,000.00 | 19/05-19/11 |
| 04/011/0 | Ndërtimi i rrugës Lushnjë-Fier dhe mbikëqyrja e punëve për dyja seksionet e njëpasnjëshme Lushnjë-Fier-Vlorë dhe Fier | 10/29/2004 | Euro | 24,350,000.00 | 24/02-24/08 |



LIGJ
Nr.10 477, datë 3.11.2011

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJË-HERCEGOVINËS PËR ZGJIDHJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR SHLYERJEN E SHUMAVE NË LLOGARINË E SHKËMBIMIT TË MALLRAVE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ISH-REPUBLIKËS FEDERALE SOCIALISTE TË JUGOSLLAVISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë për shlyerjen e shumave në llogarinë e shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7160, datë 15.11.2011, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJË-HERCEGOVINËS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI SHLYERJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË LIDHJE ME SHLYERJEN E SHUMAVE NË LLOGARITË SIPAS SHKËMBIMIT TË MALLRAVE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ISH-REPUBLIKËS FEDERALE SOCIALISTE TË JUGOSLLAVISË

Këshilli i Ministrave i Bosnjë-Hercegovinës dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (këtu quhen palët),

duke synuar zbatimin e Memorandumit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Republikës së Serbisë, Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë në lidhje me shlyerjen e shumave në llogaritë sipas shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë (këtu quhet memorandum);

me synimin e rregullimit përfundimisht të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë mbi gjendjen përfundimtare të shlyerjes, në lidhje me shkëmbimin e mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, referuar Bosnjë-Hercegovinës në pajtim me nenin 4 të memorandumit;

dhe për të zhvilluar dhe fuqizuar më tej marrëdhëniet reciproke tregtare, financiare dhe ekonomike ndërmjet të dyja vendeve,
kanë rënë dakord si më poshtë:

I. HYRJE

Neni 1

Objekti i marrëveshjes

1. Objekti i kësaj marrëveshjeje është shlyerja e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Bosnjë-Hercegovinës, gjendja përfundimtare e shlyerjes në lidhje me shkëmbimin e mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, referuar Bosnjë-Hercegovinës mbi bazën e aneksit C të marrëveshjes “Mbi çështjet e trashëgimisë së ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë”.

2. Gjendja e shlyerjes përfundimtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, duke përfshirë interesin e rregullt të llogaritur për periudhën nga 31 mars 2006 deri më 30 shtator 2009, është 3,696,189.56 dollarë kleringu (me fjalë: tre milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë dhe 56/100 dollarë amerikanë kleringu).

3. Shuma e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni përbën borxhin e Republikës së Shqipërisë ndaj Bosnjë-Hercegovinës në dollarë kleringu të datës 30 shtator 2009.

4. Palët bien dakord që borxhi i llogaritur në dollarë kleringu sipas parashikimit të nenit 1.3 do të konvertohet në borxhin e llogaritur në dollarë amerikanë (USD), duke zbatuar kursin e këmbimit prej një dollar kleringu = 1 dollar amerikan.

5. Palët bien dakord që pas konvertimit të përmendur në nenin 1.4, borxhi i Republikës së Shqipërisë ndaj Bosnjë-Hercegovinës, që nga data 30 shtator 2009, është 3,696,189.56 dollarë amerikanë (me fjalë: tre milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e nëntë dhe 56/100 dollarë amerikanë).

II. PARIME TË PËRGJITHSHME, PRIVILEGJE DHE DETYRIME

Neni 2

Shuma që rregullohet

Detyrimet e Republikës së Shqipërisë ndaj Bosnjë-Hercegovinës bëhen 3,696,189.56 dollarë amerikanë.

Neni 3

Interesi

Palët bien dakord mbi kushtet e mëposhtme për shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Bosnjë-Hercegovinës.

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave e Shqipërisë, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, do të transferojë në llogarinë e specifikuar paraprakisht nga Ministria e Financave dhe Thesarit e Bosnjë-Hercegovinës, shumën e plotë të borxhit, në mënyrën e mëposhtme:

a) Gjashtë pagesa gjysmëvjetore për shumën principale të datës 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti, që këtu përcaktohen si data pagese;

b) Data e parë e pagesës së shumës principale dhe interesit është data që vjen e para pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Ministria e Financave e Shqipërisë, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i paguan Ministrisë së Financave dhe Thesarit të Bosnjë-Hercegovinës interesin e rregullt, që fillon më 1 tetor 2009 deri në datën e shlyerjes së plotë të borxhit:



- a) Interesi llogaritet bazuar në numrin faktik të ditëve që kanë kaluar dhe një viti me 360 ditë;
- b) Norma e zbatueshme e interesit është 6 muaj LIBOR USD më 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti. Nëse 31 marsi ose 30 shtatori bien në një ditë pushimi të një vendi, norma LIBOR USD e zbatueshme është ajo e ditës së mëparshme të punës; dhe
- c) Ministria e Financave dhe Thesarit e Bosnjë-Hercegovinës i dërgon një njoftim Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me llogaritjen e interesit.
3. Interesi i zbatueshëm mbi pagesat e vonuara të shumës principale dhe interesit (interesi i vonuar) llogaritet në një normë 6-mujore LIBOR USD plus 2% në vit.

Neni 4

Autoritetet kompetente të palëve

Autoritetet kompetente të palëve për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë Ministria e Financave dhe Thesarit të Bosnjë-Hercegovinës dhe Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë.

Njoftimet duhet të bëhen në pajtim me këtë marrëveshje dhe adresohen si më poshtë:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Financave

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Borxhit Publik

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, Tiranë, Shqipëri

Tel.: ++ 3554228405

Faks: ++ 3554228494

Për Këshillin e Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës:

Ministria e Financave dhe e Thesarit

Spektori i Zbatimit të Trashëgimisë së ish-RFSJ-së dhe Menaxhimi i Sendeve Pasurore të BH-së

Trg BiH 1,71 000 Sarajevo

Tel.: + 38733254230

Faks: + 38733200395

Neni 5

Arbitrazhi

Palët bien dakord të zgjidhin mosmarrëveshjet që rrjedhin nga kjo marrëveshje me pajtim.

Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me pajtim, palët bien dakord që mosmarrëveshja të zgjidhet përfundimisht në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

Vendimi i arbitrazhit është përfundimtar, detyrues për të dyja palët dhe i zbatueshëm brenda afatit të përcaktuar në vendim.

Palët bien dakord që arbitrazhi të zhvillohet me pajtim me procedurën e përcaktuar në Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris. Ligji i zbatueshëm është ligj lëndor francez.

Neni 6

Ndryshimet

Kjo marrëveshje ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.

III. HYRJA NË FUQI

Neni 7

Ratifikimi i marrëveshjes

1. Palët e ratifikojnë këtë marrëveshje në pajtim me rregullat dhe rregulloret e tyre të brendshme.

2. Secila palë njofton tjetrën që ajo ka përfunduar procedurat e saj të brendshme. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë pas mbarimit të muajit të njoftimit përkatës të fundit.

Bërë më _____ 2011, në tri kopje origjinale, në gjuhën angleze, ku të tria kopjet origjinale janë identike.

VENDIM

Nr.744, datë 26.10.2011

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË REPUBLIKËS DEMOKRATIKE TË SOMALISË, PËR LEHTËSIMIN E PASOJAVE TË SHKAKTUARA NGA THATËSIRA E TEJZGJATUR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, t’i shtohet kundërvlera e fondit 50 000 (pesëdhjetë mijë) dollarë amerikanë, për t’u dhënë si ndihmë financiare për Qeverinë e Republikës Demokratike të Somalisë, për lehtësimin e pasojave të shkaktuara nga thatësira e tejzgjatur.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.745, datë 20.10.2011

PËR STRUKTURAT E KOMITETIT KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA (KKDM)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 13 të ligjit nr.8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) vetë, të cilët emërohen, si më poshtë vijon:



- Kryetari dhe nënkryetari emërohen për një mandat 5-vjeçar (pesëvjeçar) nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.

- Sekretar i KKDM-së është sekretari i Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha (SKDM), pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

- Anëtarët emërohen, për një mandat 4-vjeçar (katërvjeçar), nga Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, sipas propozimeve të mëposhtme:

- a) 3 (tre) anëtarë nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- b) 2 (dy) anëtarë nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- c) 1 (një) anëtar nga Ministri i Brendshëm;
- ç) 1 (një) anëtar nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- d) 1 (një) anëtar nga Universiteti Politeknik.

2. Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, që emërohen, për një mandat 5-vjeçar (pesëvjeçar), nga Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, nga të cilët 1 (një) anëtar është përfaqësues i Sekretariatit Teknik të Ujërave, i propozuar nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

3. Anëtarëve të KKDM-së dhe KTPD-së për veprimtarinë e tyre në këto organizma u jepet shpërblim sipas mënyrës dhe masës së përcaktuar në mbështetje të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”.

4. Mjediset e punës për KKDM-në, SKDM-në dhe KTPD-në sigurohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

5. Për shpenzimet dhe pagat ka buxhet të veçantë dhe këto shpenzime përballohen nga buxheti i miratuar për çdo vit, për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

6. Vendimi nr.3, datë 5.1.2002 i Këshillit të Ministrave “Për strukturën e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM)”, i ndryshuar, dhe çdo akt nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.746, datë 12.10.2011

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS NDËRKOMBËTARE TË ARBITRAZHIT,
PËR ÇËSHTJEN NR.13205-FM “ITALSTRADÉ SPA, KUNDËR REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit nr.13205-FM, datë 14.2.2006 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, për çështjen “Italstrade s.p.a., kundër Republikës së Shqipërisë”, në vlerën 4 000 000 (katër milionë) euro, vlerë për të cilën është rënë dakord sipas marrëveshjes së negocimit me kompaninë “Italstrade” s.p.a., bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Fondet përkatëse për kryerjen e pagesës sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për vitin 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.43, datë 31.10.2011

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.38, DATË 23.9.2011 “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2011-2012”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.627, datë 31.8.2011 “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifave të shkolimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2011-2012”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga “Posta Shqiptare” sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”,

UDHËZOJ:

1. Pas pikës 7 të udhëzimit nr.38, datë 23.9.2011 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012”, shtohen pikat 7.1, 7.2 dhe 7.3, si më poshtë:

“7.1 Aplikimi i kandidatëve që do t’u nënshtrohen konkurseve të pranimit, në programin e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës (UST), të zhvillohet nga data 1.11.2011 deri në datën 4.11.2011, prej orës 8:00 deri në orën 16:00, pranë sekretarive mësimore të UST-së. Konkursi i pranimit zhvillohet më datë 5.11.2011.

7.2 Universiteti i Sporteve të Tiranës të shpallë dhe të afishojë listat e kandidatëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16:00 të datës 7.11.2011, të ndara sipas programeve të studimit përkatës.

7.3 Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë ku janë shpallur fitues, të zhvillohet nga data 8.11.2011 deri në datën 11.11.2011, prej orës 8:00 deri në orën 16:00, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.”.

2. Ngarkohen Zëvendësministri, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Universiteti i Sporteve të Tiranës për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj



VENDIM
Nr.49, datë 21.11.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | | |
|-------------------|---------|---|----------|-------------|
| Bashkim Dedja | Kryetar | i | Gjykatës | Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | Anëtar | i | “ | “ |
| Petrit Ploçi | Anëtar | i | “ | “ |
| Vitore Tusha | Anëtare | e | “ | “ |
| Sokol Berberi | Anëtar | i | “ | “ |
| Fatmir Hoxha | Anëtar | i | “ | “ |
| Admir Thanza | Anëtar | i | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | Anëtare | e | “ | “ |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar | i | “ | “ |

me sekretare Enina Mullaj, më datë 13.9.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.33 Akti, që i përket:

KËRKUES: Engjëll Allajbej, në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Drejtësisë, në mungesë; Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga Abaz Deda, me autorizim; Zyra e Përmbarrimit Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: - Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut.

- Dëmshpërblimin e dëmit si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, Avokatura e Shtetit, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi ka qenë i punësuar pranë zyrës vendore të Avokaturës së Shtetit, Tiranë me detyrën e Avokatit të Shtetit. Me urdhrin nr.40, datë 27.2.2006 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, ai është liruar nga detyra. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë për shfuqizimin e urdhrin të mësipërm, rikthimin në detyrë dhe dëmshpërblimin për largimin e padrejtë nga detyra.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.3757, datë 26.6.2006, ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë: “Shfuqizimin e urdhrin nr.40, datë 27.2.2006 të palës së paditur; detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me pagën e një viti pune, si dhe dy muaj për afatin e njoftimit.”

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.978, datë 20.7.2007, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr.3757, datë 26.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2009-710, datë 13.7.2009 ka vendosur mospranimin e rekursit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 12.2.2010 ka vendosur lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të vendimit nr.3757, datë 26.6.2006.

Kërkuesi, më datë 8.3.2010, ka depozituar pranë Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë kërkesën për ekzekutimin e urdhrin të ekzekutimit. Më datë 24.3.2010, nga Zyra e Përmbarrimit është bërë lajmërimi i 7500

palës debitore, Avokaturës së Shtetit, për ekzekutim vullnetar. Pavarësisht lajmërimit, pala debitore nuk e ka kryer ekzekutimin. Për këtë arsye, Zyra e Përmbarrimit, më datë 11.6.2010, ka nxjerrë vendimin për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Pas të gjitha këtyre veprimeve të Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, vendimi gjyqësor i formës së prerë është ende i paekzekutuar.

1. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm dhe kërkon:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor;
- Përcaktimin e organit shtetëror përgjegjës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, metodën dhe afatin e qartë të ekzekutimit të vendimit;
- Dëmshpërblimin shtesë në shumën prej 3.000.000 lekësh për mosekzekutimin e vendimit deri tani;
- Përcaktimin e interesit të papaguar, siç vepron Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJENDJ).

2. *Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit*, pranon se vendimi i formës së prerë është ende i paekzekutuar për shkak të mospasjes së fondeve të mjaftueshme për këtë qëllim. Megjithatë, ai parashtron se ka filluar ekzekutimi i vendimit të formës së prerë. Për të vërtetuar këtë fakt, ai ka paraqitur urdhërshpenzimin nr.96, datë 18.4.2011, të lëshuar nga Avokatura e Shtetit, nëpërmjet të cilit është bërë pagesa prej 90.000 (nëntëdhjetë mijë) lekësh ndaj kërkuesit. Për këtë arsye, Avokatura e Shtetit kërkon që ky veprim të konsiderohet si shprehje e vullnetit që ka debitori për të shlyer detyrimin ndaj kërkuesit. Ai siguron se shlyerja e detyrimit do të vazhdojë të bëhet me këste, me qëllim plotësimin e detyrimeve ndaj disa kreditorëve njëkohësisht dhe në varësi të buxhetit të akorduar për këtë qëllim nga Ministria e Drejtësisë. Për këtë arsye, ai kërkon mospranimin e kërkesës për mosekzekutim të vendimit tej një afati të arsyeshëm. Në mbështetje të këtij argumenti ai sjell edhe faktin e veprimit me vonesë të kërkuesit, si dhe fillimin e afatit të ekzekutimit pas vendimit të Gjykatës së Lartë dhe jo të Gjykatës së Apelit Tiranë.

II

Lidhur me mosekzekutimin e vendimit brenda afatit të arsyeshëm

Kërkuesi pretendon se, që prej marrjes së vendimit formë të prerë dhe lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit, ka kaluar një kohë e gjatë, e cila është e pajustificuar për ekzekutimin e vendimit.

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) çmon se shteti i së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në zbatim urdhërimet ose vendimet gjyqësore të formës së prerë. Në praktikën e saj të vazhdueshme kjo Gjykatë ka mbajtur të njëjtin qëndrim në vendimmarrjen e saj dhe ka pranuar se: *“...parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj... ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”* (vendimet: nr.43/2007; nr.1/2009; nr.6/2009 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata thekson se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze, mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla mund të thuhet se procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (vendime: nr.6/2009; nr.13/2010; nr.35/2010; nr.21/2011 të Gjykatës Kushtetuese).



Duke u nisur nga sa më lart, Gjykata e shih me vend të shqyrtojë veprimet konkrete të kreditorit, debitorit dhe të Zyrës së Përmbarrimit lidhur me afatin kohor të arsyeshëm.

Gjykata vëren se, në bazë të nenit 511 të KPC-së titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesë të kreditorit. Sipas dosjes gjyqësore, rezultojnë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, më datë 12.2.2010, ka vendur lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit të vendimit nr.3757, datë 26.6.2006. Kërkuuesi, më datë 8.3.2010, ka depozituar pranë Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë kërkesën për zbatimin e urdhrimit të ekzekutimit. Në datë 24.3.2010 nga Zyra e Përmbarrimit është bërë lajmërimi i palës debitore, Avokaturës së Shtetit, për ekzekutim vullnetar. Më datë 11.6.2010, Zyra e Përmbarrimit ka nxjerrë vendimin për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Pra, nga këto fakte rezultojnë se kërkuuesi i është drejtuar Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, disa muaj më vonë. Për këtë arsye, koha nga vendimi i instancës së fundit gjyqësore, pra i Gjykatës së Lartë që mban datën 13.7.2009, e deri në datën kur kërkuuesi i është drejtuar Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, më datë 8.3.2010, nuk mund të llogaritet si pjesë e afatit kohor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, pasi në këtë rast shkak i vonësës është vetë kërkuuesi.

Sa i takon veprimeve të debitorit, sipas deklarimeve të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, ky i fundit i paraqet çdo vit buxhetin e tij për miratim Ministrisë së Drejtësisë, e cila bën më pas edhe planifikimin e buxhetit në tërësi të institucioneve në varësi të saj. Këtë gjë ajo e ka bërë nëpërmjet shkresës nr.(s'ka) datë 21.4.2010 për shtesë fondesh për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Të njëjtën kërkesë Avokatura e Shtetit e ka paraqitur edhe me shkresën nr.287/2, datë 6.4.2011, si dhe me shkresën nr.343/3, datë 2.6.2011. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr.4073, datë 14.6.2011, ka kthyer përgjigje se Ministria e Financave nuk disponon fonde të paspërndara me përjashtim të fondit rezervë të Buxhetit të Shtetit. Megjithatë, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me urdhrin nr.15, datë 15.4.2011, ka urdhëruar zbatimin e vendimit nr.3757, datë 26.6.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më tej, Avokatura e Shtetit, me urdhërshepenzin nr.96, datë 18.4.2011, ka filluar ekzekutimin e vendimit të mësipërm duke i akorduar kreditorit shumën prej 90.000 (nëntëdhjetë mijë) lekësh. Gjithashtu, është planifikuar nga pala debitore që të gjitha detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të parashikohen në buxhetin e shtetit për vitin 2012. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, deklaroi para Gjykatës se shlyerja e detyrimit do të vazhdojë me pjesë, deri në realizimin e plotë të detyrimit që rrjedh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se debitori, Avokatura e Shtetit, ka shfaqur vullnetin se do të plotësojë të gjithë detyrimin ndaj kreditorit sipas përcaktimit të gjykatës brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se nisur nga sjella e institucionit debitor që ka për detyrë të ekzekutojë vendimin gjyqësor të formës së prerë nuk konstatohet mungesë vullneti për të mos shlyer pjesën e mbetur të detyrimit që rrjedh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë me qëllim realizimin e së drejtës së ligjshme të kreditorit.

Për këtë arsye, Gjykata çmon se nuk ndodhet para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi procesi i shlyerjes së detyrimit ndaj kreditorit ka filluar dhe po vazhdon. Gjithashtu, Gjykata nuk konstaton veprime që mund të kenë çuar drejt një tejzgjatje të afatit të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, ndryshe nga sa pretendon kërkuuesi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza.

VENDIM

Nr.75, datë 26.10.2011

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3 pika 3, nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 26 pika 1 shkronja “a”, nenit 57 pikat 2, 3, 4 dhe 5 të nenit 58 pika 1 dhe nenit 66 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit” miratuar me vendimin nr.71, datë 14.10.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, pika 2, shtohet shkronja “k”, me përmbajtjen e mëposhtme:

“...k. “Haircut” është përqindja me të cilën pakësohet vlera e aktivitetit likuid për qëllime të përlllogaritjes së treguesit të likuiditetit, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.”.

b) Në nenin 19, pika 3 ndryshon si më poshtë:

“...3. Banka përlllogarit dhe siguron në çdo kohë respektimin e treguesit të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra:

a) në monedhën kombëtare (lekë) dhe në monedhë të huaj në nivelin minimal 20 % (njëzet për qind); dhe

b) në total në nivelin minimal 25 % (njëzet e pesë për qind).”.

c) Në nenin 19, pika 4, shkronja “b” ndryshon si më poshtë:

“...b. llogarit me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, të përcaktuar me akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë;”.

d) Në nenin 19, pika 4, shtohet paragrafi me përmbajtjen e mëposhtme:

“... 4. Aktivitetet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “k”, “l” dhe “m” konsiderohen aktive me likuiditet të lartë.”.

e) Në nenin 19, pika 6, në fund të fjalisë së parë, pas fjalës “vit” shtohet shprehja e mëposhtme:

“... përveç letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes, si dhe të depozitave nga të tretë të bllokuara si kolateral/garanci në bazë të një marrëveshjeje të caktuar me bankën.”.

f) Në nenin 19 shtohen pikat 5 dhe 6, respektivisht me përmbajtjen e mëposhtme, ndërkohë që pikat 5, 6 dhe 7 ekzistuese rinumërohen përkatësisht 7, 8 dhe 9:

“...5. Të gjitha aktivitetet likuide të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, do të përfshihen si të tilla vetëm në rastin kur mbi to nuk ekziston asnjë marrëveshje ose angazhim, i cili kufizon aftësinë e bankës për t’i zotëruar ato lirisht dhe në mënyrë të pavarur në rast nevojë, aktualisht dhe në të ardhmen.

...6. Bankat përfshijnë në treguesin e aktiveve likuide, zërat e përcaktuar në shkronjat “h”, “i”, “j”, “n” dhe “o” të pikës 4 të këtij neni, duke përdorur *haircut-et* e përcaktuara në tabelën e mëposhtme:



| Nr. | Klasifikimi (rating) i kundërpartisë jorezidente sipas S&P ose të barasvlershëm me të | Haircut |
|-----|---|---------|
| 1. | mbi BBB-* | 0% |
| 2. | BB+ | 10% |
| 3. | BB | 20% |
| 4. | BB- | 30% |
| 5. | B+ | 40% |
| 6. | B | 50% |
| 7. | B- | 60% |
| 8. | nën CCC+** | 100% |

Shënim sqarues: * përfshirë BBB-; **përfshirë CCC+.”.

g) Neni 20, pikat 1 dhe 3 riformulohen si më poshtë:

“...1. Bankat paraqesin në fund të çdo muaji në Bankën e Shqipërisë, formularët e përcaktuar në aneksin 2 të kësaj rregulloreje. Bankat respektojnë kufirin e treguesit të përcaktuar në nenin 19, paragrafi 3, shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj rregulloreje dhe raportojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë në rast të mosrespektimit të tij.

...3. Banka e Shqipërisë, kur konstaton situata të vështira të likuiditetit ose kur ajo e gjykon të arsyeshme, mund të kërkojë informacion më të zgjeruar dhe më të shpeshtë, si dhe mund të vendosë kërkesa dhe norma më kufizuese të përkohshme për administrimin e rrezikut të likuiditetit sesa ato të parashikuara në këtë rregullore, për banka individuale. Në këto raste, bankat sigurojnë nëpërmjet strukturave përkatëse një komunikim sa më efektiv dhe informacion të plotë sipas kërkesës së Bankës së Shqipërisë.”.

h) Në nenin 20 shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

“...4. Bankat raportojnë në baza javore në Bankën e Shqipërisë, parashikimet për flukset hyrëse dhe dalëse të parasë, sipas përcaktimeve të nenit 14 të kësaj rregulloreje.”.

2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit European dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.107, datë 17.10.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË “RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE
PROCEDURAVE TË ERE-S”, TË MIRATUARA ME VENDIMIN NR.21, DATË 18.3.2009 TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 39 të “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.10.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga grupi i punës për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”,

VENDOSI:

Të miratojë shtesat dhe ndryshimet në “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s (ndryshimet bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

SHTESAT DHE NDRYSHIMET NË
“RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE PROCEDURAVE TË ERE-S” TË MIRATUARA ME
VENDIMIN NR.21, DATË 18.3.2009 TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S

A) Në nenin 3 “Zbatimi”, pas germës “g” të pikës 1, shtohet germa “h” me përmbajtjen si më poshtë:

“h. trajtimin e ankesave të konsumatorëve.”.

B) Në nenin 5 “Sekretar/e”, pika 6 ndryshon dhe bëhet:

“Sekretar/e” do të thotë Sekretari/ja e titullarit të ERE-s.”.

C) Në nenin 5 “Tarifat dhe çmimet”, pika 20 ndryshon dhe bëhet:

“Tarifat dhe çmimet” janë pagesat që duhet të kryhen nga konsumatorët për shërbimet e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, që sigurohen nga shoqëritë e licencuara nga ERE, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike apo gazit natyror mund të rishikohen nga ERE me propozim të të licencuarve ose me iniciativën e vetë ERE-s, sipas parimeve të parashikuara në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe në ligjin nr.9646, datë 30.6.2008 “Për gazin natyror.”.

D) Në nenin 5, pas pikës 24, shtohen pikat 25 dhe 26:

25. “Akt individual” do të thotë çdo vendim që krijon pasoja juridike individualisht.

26. “Akt normativ” do të thotë çdo vendim që krijon pasoja juridike për më shumë se një individ.”.

DH) Në nenin 8 “Mbledhjet e Bordit të Komisionerëve” pikat 4, 5 dhe 6 ndryshojnë dhe bëhen:

4. Përpara çdo mbledhjeje të bordit, kryetari përgatit një agjendë të çështjeve për t’u shqyrtuar në bord. Sekretari/ja ua shpërndan këtë agjendë, anëtarëve të Bordit të Komisionerëve, si dhe drejtorive që kanë ndjekur një procedurë. Kjo agjendë është e disponueshme për inspektim publik në zyrat e ERE-s.

5. Njoftimi i mbledhjes, komunikohet të paktën 5 ditë kalendarike përpara datës së caktuar për mbledhjen.

6. Afati i përcaktuar në pikën 5 të këtij neni nuk zbatohet nëse në aktet e tjera ligjore që kanë fuqi detyruese për ERE-n përcaktohen afate të ndryshme. Në këtë rast agjenda dhe materialet shoqëruese të nevojshme për vendimmarrje do t’i dërgohen bordit të paktën 24 orë para mbledhjes së Bordit.”.

DH.1) Në nenin 8 “Mbledhjet e Bordit të Komisionerëve” pas pikës 6 shtohet pika 7 me përmbajtjen:

“7. Me kërkesën e një prej anëtarëve të tij, bordi mund të vendosë të heqë ose shtojë çështje të veçanta nga agjenda e përgatitur.”.

E) Në nenin 9 “Mbledhjet jashtë radhe” pas fjalëve “jo më vonë se dy ditë” shtohen fjala “pune”.

Ë) Në nenin 12 “Organizimi i mbledhjes së hapur”, pikat 3 dhe 4 ndryshojnë si më poshtë:

3. Në një mbledhje të hapur të bordit të ERE-s, kanë të drejtë të diskutojnë dhe të japin mendime, vetëm anëtarët e bordit dhe përfaqësuesit e ERE-s, si dhe me leje të kryetarit të ERE-s, edhe persona të tjerë që kanë lidhje me çështjet në agjendë.



4. Me kërkesë të palëve të interesuara, sekretarja e bordit u lejon atyre që të njihen me procesverbalin e mbledhjes, si dhe me vendimin e bordit pas zbardhjes së tyre.”.

F) Në nenin 13 “Të drejta e detyrime të publikut”, në pikën 1 në fund të fjalisë shtohet paragrafi me përmbajtjen si më poshtë:

“- Mbledhjet e hapura të Bordit të Komisionerëve mund të regjistrohen nga përfaqësues të autorizuar të shtypit të shkruar dhe audioviziv pas miratimit të kryetarit.”.

F.1) Pika 3 e këtij neni ndryshon si më poshtë:

“Pika 3 e nenit 13

Kur cenohen rregullat mbi zhvillimin e mbledhjes, kryetari pas konsultimit me bordin vendos për ndërprerjen e mbledhjes për një periudhë të caktuar kohe, ose shtyrjen e saj pas marrjes së miratimit nga bordi.”.

G) Në nenin 15 “Vendimmarrja”, pas fjalëve “brenda tre ditëve” shtohen fjala “pune nga zbardhja e vendimit”.

H) Në nenin 16 “Kërkesë për rishikimin e një vendimi të bordit”, ndryshohen dhe bëhen:

“1. Për një vendim të bordit, për një çështje me karakter individual, çdo person i përfshirë në çështje, që ka siguruar apo disponon prova të reja, që mund ta çojnë bordin të marrë një vendim të ndryshëm, personi i prekur nga akti mund t’i kërkojë ERE-s rishikimin e vendimit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes e njoftimit të vendimit. Bordi do të shqyrtojë provën e re dhe do të nxjerrë vendimin e tij brenda 12 (dymbëdhjetë) ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës për rishikim. Kërkesa për rishikim nuk do të lejojë personin që paraqet kërkesën të ndërpresë ekzekutimin e vendimit të parë të bordit brenda afateve të përcaktuara, përveç kur është pezulluar nga bordi nën autoritetin e tij.

2. Bordi në përputhje me rrethanat specifike të një vendimmarrjeje, me iniciativën e tij mund të rishikojë vendimet me karakter individual. Bordi nuk mund të vendosë me iniciativën e tij për të rishikuar një vendim, kur nga rishikimi kufizohen të drejta të dhëna më parë me vendimin që kërkohet të rishikohet.

3. Për aktet me karakter normativ, çdo palë e përfshirë në proces mund të paraqesë në ERE një kërkesë për rishikim vendimi të Bordit të Komisionerëve brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së njoftimit të vendimi të bordit. Kërkesa për rishikim vendimi do të shoqërohet detyrimisht me provat e reja që mendohet se mund të çojnë bordin në një vendimmarrje të re. ERE do të trajtojë kërkesën për rishikim vendimi brenda 30 ditëve kalendarike duke ndjekur të njëjtin proces që shërbeu për miratimin e vendimin. Kërkesa për rishikim vendimi nuk pezullon zbatimin e vendimit me përjashtim kur Bordi i Komisionerëve vendos ndryshe.

4. Pezullimi i aktit të miratuar nga ERE, bëhet vetëm nga Bordi i Komisionerëve të saj, sipas një kërkesë të paraqitur nga një subjekt i interesuar, në përputhje me rrethanat specifike.

Bordi i Komisionerëve të ERE-s nuk mund të vendosë për pezullimin e zbatimit të një akti të tij, në rastet kur:

- Pezullimi i aktit ndalohet me ligj;
- Zbatimi i menjëhershëm i tij është në interes publik.”.

H.1 Pas nenit 16 shtohet neni 16/1:

“Neni 16/1

Çdo person në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe ligjin nr.9646, datë 30.6.2008 “Për gazin natyror” mund të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.”.

I) Në nenin 17 “Regjistrimi i aplikimit apo kërkesës”, pika 4 ndryshon dhe bëhet:

“4. Të gjithë regjistrat, shënimet dhe materialet e tjera të përshkruara në këtë nen, janë të hapura për publikun me përjashtim të atyre që trajtohen si konfidenciale, sikurse vendosur sipas rastit nga organet drejtuese të ERE-s.”.

J) Në nenin 18 “Fillimi i procedurës”, në pikën 1 pas germës “d” shtohet germa “e” me përmbajtjen si më poshtë:

“e) për kërkesat për përjashtim nga aksesimi i palëve të treta të infrastrukturave të reja apo ekzistuese të gazit natyror.”.

J.1) Kudo në këtë nen afatet përcaktohen në ditë pune.

J.2) Pika 4 dhe 5 e nenit 18 hiqet.

K) Në nenin 20 “Procedura e aplikimeve për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve”, pika 1 ndryshon dhe bëhet:

“1. I licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim, të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, sipas metodologjisë përkatëse dhe rregullave të tjera të ERE-s.”.

L) Në nenin 21 “Rregulla të veçanta për paraqitjen e aplikimeve për përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe/apo të gazit natyror nga shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë”, pika 7 ndryshon dhe bëhet:

“7. Pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave të shqyrtimit aplikuesi duhet të njoftojë:

- Brenda 10 ditëve kalendarike publikun, nëpërmjet botimit jo më pak se në dy/tre gazeta me qarkullim në nivel vendi, apo në zonën ku aplikuesi siguron shërbimin, në lidhje me masën e propozuar për ndryshimin e tarifave dhe çmimeve, si dhe përqindjen e ndryshimit të tyre për çdo klasë/grup konsumatorësh duke shprehur qartë emërtimin e tyre.

- Në rastet kur aplikuesi nuk bën publikimin sipas paragrafit të mësipërm, ERE-ja mund të vendosë për penalizimin e aplikuesit dhe bën publikimin e aplikimit sipas kërkesave të paragrafit të mësipërm. Kostot e botimit të këtij njoftimi i transferohen subjektit që ka detyrimin për zbatimin e paragrafit të parë të pikës 7.”.

LL) Në nenin 22 “Zgjidhja e ankesave” bëhen këto ndryshime:

Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“Për mosmarrëveshjet midis të licencuarit dhe klientëve të tij, si dhe midis vetë të licencuarve, çdo ankues duhet të paraqesë në ERE kërkesën duke përdorur formën standarde që i bashkëlidhet këtyre rregullave.”.

Pika 7 ndryshon si më poshtë:

“Ankesat që përmbajnë materiale fyese ose denigruese nuk trajtohen nga ERE, pa paragjykuar nëse ai ankues mund të ketë paraqitur një ankesë të ligjshme. ERE i bën me dije ankuesit arsyet e mostrajimit të ankesës së tij.”.

Pika 10 ndryshon dhe bëhet:

“Në çdo rast ERE rezervon të drejtën për të zhvilluar seanca dëgjimore publike, si dhe/apo të kryejë kryesisht verifikime apo inspektime.”.

LL.1) Pas pikës 11 shtohen pikat 12, 13 dhe 14 me përmbajtjen si më poshtë:

“12. Për mosmarrëveshjet midis të licencuarve apo midis të licencuarit dhe konsumatorit, objekti i të cilëve paralelisht lidhet me një vendimarrje tjetër në proces nga Bordi i Komisionerëve, atëherë afatet e përcaktuara me sipër apo zhvillimi i mundshëm i seancave dëgjimore do të bëhet në afate të ndryshme nga sa përcaktuar në këtë nen, për të mundësuar trajtimin e ankesës brenda afatit të shqyrtimit të çështjes në procedim nga bordi që ka lidhje edhe me objektin e ankesës.

13. Për ankesat e përsëritura të paraqitura nga të licencuarit, me të njëjtat palë dhe me të njëjtin objekt, njoftohen anëtarët e bordit brenda 2 ditësh pune për ankesën apo mosmarrëveshjen e riparaqitur në ERE dhe brenda 5 ditësh pune nga njohja me të, kryetari zhvillon një mbledhje të bordit, i cili përcakton më pas natyrën sesi do të procedohet me ankimin apo mosmarrëveshjen. Mbledhjet e bordit të parashikuara sipas kësaj pike do të jenë të karakterit informativ dhe udhëzues për zgjidhjen e çështjes objekt i mosmarrëveshjes, apo ankesës nga personeli teknik i ERE-s. Për ankesat e përsëritura të paraqitura nga konsumatorët ndaj një të licencuari, bordi mund të vendosë rast pas rasti me kërkesë të kryetarit për zgjidhjen e mëtejshme të ankesës.

14. Në çdo kohë kur e konsideron të nevojshme kryetari i ERE-s mund të kërkojë trajtimin nga Bordi i Komisionerëve të një ankesë të paraqitur në ERE, brenda autoritetit dhe kompetencës së dhënë nga legjislati në fuqi.”.

M) Pika 2 e nenit 23 ndryshon dhe bëhet:



“Çdo person që paraqet një kërkesë në ERE mund ta dërgojë atë nëpërmjet postës zyrtare apo në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

N) Në nenin 25 ndryshon titulli dhe bëhet: “Rregullat për hartimin e miratimin e akteve nënligjore me statusin: rregullore, udhëzim, metodologji etj.”.

N.1) Pikat 1, 3 dhe 4 të këtij neni ndryshojnë dhe bëhen:

“1. Për hartimin e një akti nënligjor që ka të bëjë me ushtrimin nga ana e ERE-s të autoritetit në drejtim të miratimit të legjislacionit sekondar, me iniciativën e vet apo me propozim të subjekteve që kanë të drejtën e hartimit të një akti, objekt i miratimit nga ERE, kryetari, në konsultim me anëtarët e bordit, urdhëron ngritjen e një grupi pune. Pas hartimit të draftit, apo pas analizës së draftit, në rastet e propozimeve nga subjektet që kanë të drejtën e një propozimi në ERE, ky grup pune publikon për 3 ditë pune një njoftim në 2 gazeta me qarkullim kombëtar duke ftuar palët e interesuara ose persona të tjerë të njihen me projektaktin dhe të dërgojnë komente me shkrim.

3. Të gjitha palët e interesuara do të dërgojnë komentet e tyre me shkrim për projektaktin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga dita e publikimit të njoftimit.

4. ERE do t'i dërgojë kopje të aktit të miratuar të gjitha palëve që kanë shprehur komente apo interes në proces.”.

N.1) Në pikën 5 pas fjalëve “jo më pak se tre ditë” shtohen fjala “pune”.

NJ) Në nenin 26 ndryshon titulli dhe bëhet: “Rishikimi i akteve nënligjore me statusin: rregullore, udhëzim, metodologji etj.”.

NJ.1) Pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni ndryshojnë dhe bëhen:

“2. Procesi i rishikimit të akteve nënligjore me iniciativën e ERE-s, nis vetëm pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurave nga bordi.

3. Për rishikimin e akteve nënligjore me statusin: rregullore, udhëzim, metodologji etj.”, me kërkesë të palëve të interesuara, para marrjes së vendimit nga bordi për miratimin ose jo të ndryshimeve të propozuara, ERE do të zhvillojë një seancë dëgjimi me subjektin që ka kërkuar ndryshimin apo palët e interesuara, duke ftuar dhe sipas rastit, palët e tjera, që mund të preken nga ndryshimet e propozuara.

4. Për rishikimin e akteve nënligjore me iniciativën e ERE-s apo me kërkesë të palëve të interesuara ndiqet e njëjta procedurë e përcaktuar në nenin 25, pikat 1, 2, dhe 3 të këtyre rregullave.”.

O) Në nenin 31, pika 1 ndryshon dhe bëhet:

“- Për seancat dëgjimore të përgjithshme dhe teknike ERE njofton secilën nga palët që ka shprehur interes, si dhe palët e identifikuara të nevojshme për procesin, jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga data e planifikuar për zhvillimin e seancës. Njoftimi përmban informacion mbi datën, orën, vendin, qëllimin e zhvillimit të seancës dëgjimore, si dhe dokumentacionin e administruar nga ERE për çështjen objekt të seancës dëgjimore.”.

P) Në nenin 33 “Rregulla të zhvillimit të seancës dëgjimore”, pika 9 ndryshohet dhe bëhet:

“9. Nëse një seancë dëgjimore nuk arrin të ezaurojë të gjitha çështjet e planifikuara, ajo mundet të vazhdojë në një datë tjetër, e cila do të komunikohet nga ERE në përfundimin e seancës në fjalë ose nëpërmjet një komunikimi tjetër, i cili duhet t'u bëhet palëve të interesuara jo më vonë se një ditë kalendarike përpara organizimit të vijimit të seancës.”.

Q) Në nenin 38 “Konflikti me funksionet ligjore ose institucionale”, riformulohet dhe bëhet:

“Këto rregulla janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, autoritetin dhe funksionet ligjore të ERE-s. Në rast konflikti mes legjislacionit në fuqi që ka të bëjë me autoritetin dhe kompetencat e ERE-s dhe këtyre rregullave, do të prevalojë legjislacioni në fuqi.”.

KËRKESE

Kërkuesi Dritan Koldashi, i biri i Eminit dhe i Antonetës, i datëlindjes 1968, banues në Elbasan, me adresë: Lagja “28 Nëntori”, kërkon shpalljen të zhdukur të motrës së tij, shtetases Eda Hasani, e datëlindjes 9.9.1959.

Kërkuesi
Dritan Koldashi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

| | |
|---|----------|
| KODI CIVIL | 360 lekë |
| KODI I FAMILJES | 310 lekë |
| KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE | 90 lekë |
| KODI PENAL USHTARAK | 55 lekë |
| KODI I PUNËS | 140 lekë |
| KANONI I ZHURISË | 40 lekë |
| PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE | 328 lekë |
| PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË | |
| PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE | 140 lekë |
| PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË | 512 lekë |

Hyri në shtyp më 25.11.2011
Doli nga shtypi më 27.11.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2011

Çmimi 24 lekë